



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE I N.P.L "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A PODUJEVË

Në mbështetje të nenit 5.2, nenit 7, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 164, dhe nenit 182 nën par. 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 24.05.2018, bazuar në Konkursin Publik të shpallur nga Komuna e Podujevës me datë 11.07.2024 me nr. të protokollit 01-111/01-044982/24 lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve të N.P.L "Stacioni i Autobusëve" Sh. A në përbërje prej 1. Kasib Bashota- Kryesues i Komisionit, 2. Bashkim Syla-Anëtar i Komisionit dhe 3. Vigan Salihu- Anëtar Komisionit në mbledhjen e mbajtur me datë 09.08.2024, nxjerrin këtë:

VENDIM

(Për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Stacioni i Autobusëve" Sh. A)

1. Pas zhvillimit të të gjitha fazave të procedurave të rekrutimit, dhe rezultateve të arritura nga intervista me gojë, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka përzgjedhur anëtarët e Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Stacioni i Autobusëve" Sh. A si në vijim:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pikët
1	Majlinda Shabani Salihu	92
2	Albulena Uka Neziri	89

2. Ky vendim është marr nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve të cilët kanë arritur në këtë përfundim pas vlerësimit të intervistës me gojë.
3. Detyrat dhe Përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-11 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
4. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes do të jetë në periudhë tre (3) vjeçare.
5. Kompensimi i Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes, do të bëhet në pajtim me nenin 20 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
6. Për kryerjen e detyrave të cekura në par. 3 të këtij vendimi, Bordi i Drejtorëve i raporton dhe i përgjigjet Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Arsyetim

7. Me datë 11.07.2024 është shpallur konkursi publik për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, ku periudha e aplikimit ka qenë i hapur nga data 11.07.2024 deri me datë 31.07.2024 në ora 16:00.

8. Për t'u përzgjedhur për Anëtarë të bordit të Drejtorëve kanë aplikuar 7 kandidatë, Një (1) kandidat nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit publik për të u ftuar në intervistë dhe dy (2) kandidat kanë munguar në intervistë. Kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e konkursit publik janë njoftuar në lidhje me datën dhe orën se kur do të mbahet intervistimi me gojë, dhe atë janë njoftuar në faqën zyrtare të Komunës.

9. Pas përfundimit të intervistimit me gojë, kandidatët e suksesshëm në bazë të pikëve të fituara janë si në vijim:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pikët
1	Majlinda Shabani Salihu	92
2	Albulena Uka Neziri	89

Pas zhvillimit të të gjitha fazave të procedurave të rekrutimit, kandidatët në bazë të pikëve të fituara nga intervista me gojë dhe të cilët nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme për t'u përzgjedhur për anëtarë të Bordit të Drejtorëve janë si në vijim:

3	Gentianë Behrami	86
4	Hatixhe Krasniqi	74
5	Rexhep Zebica	Mungoi
6	Vjosa Zhitia	Mungoi

Detyrat dhe Përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-11 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes do të jetë në periudhë tre (3) vjeçare. Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes, do të bëhet në pajtim me nenin 20 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Komisioni Komunal i Aksionarëve në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e parapara ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kandidatët të cilët kanë aplikuar për këto pozita dhe nuk janë përfshirë në këtë listë, kanë të drejtën të parashitrojnë ankesë brenda Gjykatës kompetente brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të njoftimit. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij vendimi (nuk ka efekt suspensiv).


Vendimi publikohet në webfaqen zyrtare të Komunës së Podujevës dhe në këndin e njoftimeve si kopje fizike dhe të njejtin vendim kandidatet mundë ta marrin në kopje fizike tek Zyra e Arkivës së Komunës së Podujevës.

Komisioni:

Kasib Bashota Kryetar:

Bashkim Syla Anëtar:

Vigan Salihu Anëtar:

Handwritten signatures in blue ink. The first signature is for Kasib Bashota, the second for Bashkim Syla, and the third for Vigan Salihu. Each signature is written over a horizontal line.